

VENDIM
Nr.11, datë 17.4.2020

**PËR FALJEN E MASAVE ADMINISTRATIVE ME KARAKTER NDËSHKUES TË
VENDOSURA GJATË PERIUDHËS SË INFEKSIONIT TË SHKAKTUAR NGA
COVID-19**

Në mbështetje të ligjit nr.45/2019, “Për mbrojtjen civile”, të aktit normativ nr.3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”, të ndryshuar, të vendimit nr.243, datë 24.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, dhe në vijim të marrjes së masave për përballimin e epidemisë të shkaktuar nga COVID-19, Komiteti Ndërmintoror i Emergjencave Civile, i mbledhur sot në datën 17.4.2020,

VENDOSI:

1. Propozimin Këshillit të Ministrave për nxjerrjen e një akti normativ për faljen e të gjitha masave administrative me karakter ndëshkues, të vendosura nga autoritetet shtetërore përkatëse, për shkeljen e rregullave apo të akteve ligjore e nënligjore të nxjerra në kuadër të masave të ndërmarra për parandalimin dhe luftimin e infeksionit të shkaktuar nga COVID-19, duke filluar nga momenti i konstatimit të kësaj sëmundjeje në territorin e Republikës së Shqipërisë deri në datën 17.4.2020.

2. Në aktin normativ të përfshihet edhe kthimi i shumës së detyrimit të falur, por të paguar, për masat administrative me gjobë dhe kthimi i lejeve e i mjeteve të bllokuara, në zbatim të masave administrative, të subjekti përfitues.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ministri i Shtetit për Rindërtimin, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR I KOMITETIT NDËRMINTOROR
TË EMERGJENCAVE CIVILE**

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**